



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, *Agjencia e Statistikave të Kosovës* shpallë:

KONKURS

2. Departamenti i Llogarive Kombëtare një (1) pozitë të karrierës:

Titulli: Një (1) Zyrtarë për Tabela Ofruese-Përdoruese (SUT)

Numri i referencës : ASK-DLLK-002

Koeficienti : 7

Detyrat dhe përgjegjësit :

1. Përgatitja e komponentëve të Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale përmes tabelave ofruese.
2. Përgatitja e komponentëve të Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime konstante përmes tabelave ofruese.
3. Përgatitja e komponentëve të Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime aktuale përmes tabelave përdoruese.
4. Përgatitja e komponentëve të Bruto Produktit Vendor me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve, me çmime konstante përmes tabelave përdoruese.
5. Përpilimi i tabelave ofruese (finale) me çmime aktuale me të dy qasjet dhe krahasimi me rezultatet e Bruto Produktit Vendor në baza vjetore.
6. Përpilimi i tabelave përdoruese (finale) me çmime aktuale me të dy qasjet dhe krahasimi me rezultatet e Bruto Produktit Vendor në baza vjetore,
7. Implementimi i metodologjisë së Eurostatit (ESA2010).
8. Vlerësimi i Bruto Produktit Vendor në bazë të tabelave ofruese-përdoruese (SUT).

Kualifikimi : Diplomë universiteti, drejtimi ekonomi apo të ngjashme.

Përvoja e punës: Kandidati duhet të ketë 3 vite përvojë pune profesionale.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Njohuri për indikatorët makroekonomik;
- Aftësi të avancuara për përdorimin e kompjuterit (Microsoft Office; Excel, Word, e preferuar edhe programet tjera si Acces, SPSS etj);
- Shkathhtësi dhe nivel të lartë të absorbimit të njohurive nga Asistenca Teknike dhe leximi i manualeve dhe metodologjive të aplikuara në sistemet statistikore për Llogaritë Kombëtare (ESA2010);
- Nivel të lartë të bashkëpunimit në punë ekipore;
- Azhur dhe i gatshëm në kryerjen e detyrave;
- Aftësi mira të njohjes së gjuhës angleze.

Procedura e konkurrimit:

Në Shërbimin Civilë kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore ,të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për zbatimin funksionit administrativ dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja e Shërbyesve Civilë bëhet në pajtim me Ligjin –Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civilë të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit: Sipas Ligjit të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës , në të cilën është përfshirë periudha e punës provuese prej një (1) viti.

Konkursi është i hapur 15 dite kalendarik nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës , Rr,”Zenel Salihu” Nr.4 Prishtinë. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës profesionale , vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nënë hetime dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme , që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurren.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar , vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen testimit me shkrim dhe intervistimit.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni me zyrën e personelit , në tel: 038- 20031149, prej orës 08:00 – 16: 00.

“Shërbimi Civilë i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komuniteti jo - shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.